



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 21.09.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.09.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “TSR SHPK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi rrugor në Qerim, Piskot, Berkoc, Blloku i ri, Has, reka keqe, reka mirë”, Nr. i prokurimit- 632-26-5866-2-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-041-211, nxjerr:

V E N D I M

1. **APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “TSR SHPK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi rrugor në Qerim, Piskot, Berkoc, Blloku i ri, Has, reka keqe, reka mirë”, Nr. i prokurimit- 632-26-5866-2-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-041-211, e paraqitur kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues 09.09.2026 në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i publikuar më datë 09.09.2026..
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që ta kthejë lëndën në ri-vlerësim.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “TSR SHPK”, me dt.13.09.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit: : “Sinjalizimi rrugor në Qerim, Piskot, Berkoc, Blloku i ri, Has, reka keqe, reka mirë”, Nr. i prokurimit- 632-26-5866-2-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-041-211.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 21.09.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe, pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruara, ka konstatuar se:

-Pretendimi 1: Kontrolleri i prodhuesit SCAE i tipit VEGA nuk e ka nivelin e sigurisë së kërkuar SIL3.

Ju keni elaburuar tekstin në katalogun e këtij kontrolleri në lidhje me sigurinë që ofron ku keni potencuar se AK ju ka eliminuar sepse në dokumentacionin e VEGA-s nuk mban etiketën formale "SIL3".

Arsyeja e eliminimit që keni potencuar në ankesë nuk qëndron sepse oferta juaj në këtë pikë është vlerësuar se nuk i plotëson kriteret e dosjes së tenderit jo për faktin se VEGA nuk përmban etiketën formale për siguri në nivelin SIL3, po për faktin se VEGA SI KONTROLLER NUK KA SIGURINË FUNKSIONALE TË KRYQËZIMIT SIL 3 (SAFETY INTEGRITY LEVEL 3).

SIL 3 (Safety Integrity Level 3) është nivel shumë i lartë i integritetit të sigurisë sepse kërkon që një sistem sigurie të ketë probabilitet shumë të ulët të dështimit në kryerjen e funksionit të tij të sigurisë.

SIL 3 (Safety Integrity Level 3) është një koncept shumë i rëndësishëm për kontrollorët e semaforëve, sepse lidhet drejtpërdrejt me sigurinë funksionale të kryqëzimit.

SIL 3 (Safety Integrity Level 3) Është një klasifikim i standardit IEC 61508 që tregon se sa i aftë është një sistem sigurie për të parandaluar ose kontrolluar një dështim të rrezikshëm. Për shembull, kontrollori i tipit ITC-3 është projektuar sipas IEC/EN 61508 SIL 3 dhe përdor dy procesorë të pavarur të sigurisë.

Pretendim 1 është i pa bazuar.

-Pretendimi 2: Laterna e prodhuesit SCAE e tipi TRAFLED nuk plotëson kërkesën minimale të dosjes së tenderit.

Nga analizimi i ankesës tuaj dhe ri-shikimi i specifikimeve të semaforëve SCAE e tipi TRAFLED rezulton se semafori SCAE TRAFLED i cili ka dizajn të hollë (slim) siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe LED Modulet e tij me diametër 210 mm dhe 300 mm nuk plotësojnë kërkesën teknike tek pika:

Temperatura punuese është kërkuar: -40°C $+65^{\circ}\text{C}$, ndërsa SCAE TRAFLED ofron temperaturë punuese në domenin: -40°C $+60^{\circ}\text{C}$

Ndërsa të shkalla e mbrojtjes plotësohet kërkesa IP 65. (shiko figurën me markime).

STRUCTURAL FEATURES

- Structure with sectional elements Ø 210 mm and Ø 300 mm in higher quality polycarbonate, UV stabilized, paste coloured, available in the following standard colours: Green, Yellow, Black.
- Monobloc optics with led technology.
- Available with grey lens (not coloured).
- Doors with rapid clutch and spring-lock handle.
- Visor with rapid clutch.
- Possibility of vertical or horizontal mounting.
- Fixing for wall support, bandit and for hanging up on a cantilever pole or rope.

CONFORMITY TO NORMS

Conform to EN12368:2015 norm
CE Conformity (certificates and test reports available on request).

TECHNICAL DATA OF LED MODULES		
Traffic signal	210 mm	300 mm
Light intensity	Red > 400cd Yellow > 200cd Green > 400cd White > 400cd	Red > 400cd Yellow > 400cd Green > 400cd
Dimmer	Nighttime = 50%	
Color	Red/Yellow/Green/White	
Led type	High Flux	
Operating voltage	190-265Vac 12Vdc 32-42Vac 24Vdc/dc	
Power consumption	< 10W	
EMC	EN 50293 : class B	
Power factor	> 0.9	
Temperature range	-40°C +65°C	
Rel. Humidity	< 95%	
Protection degree	EN 60529 : IP65	
Material lens/housing	Polycarbonate	
Weight	< 1.0 Kg.	< 1.5 Kg.
Dimensions (incl. Front lens)	Ø210 x 100,2 mm	Ø300 x 132,4 mm

Figure 1: Specifikimi teknik i LED MODULIT për TRAFLED, e shkëputur nga fajlli me emrin - 6 Furnizuesit e materialit-180 kërkesa 1.pdf faqe 176-177. Shihet qartë se nuk plotësohet kërkesa minimale për temperaturën operuese të semaforit.

Lens diameter	Number of aspects	Dimensions width / height / depth [mm]	Weight* (kg)	Material	Assembly	Available colours	Temperature class	Resistance	CE Certificate
200 mm	1	269 / 264 / 130 [345*]	1,8	UV stabilized polycarbonate	Double support by means of polycarbonate (160 mm) or aluminium (200 mm) bracket, horizontal or vertical assembly. Assembly of screens with use of self-tapping screws.	black RAL 9005	A, B and C (-40°C to +65°C) in compliance with PN-EN 12368:2006	IRO in compliance with PN-EN 12368:2006	Full conformity with PN-EN 12368:2006
	2	269 / 527 / 130 [345*]	3,0			grey RAL 7032			
	3	269 / 791 / 130 [345*]	5,4			green RAL 6009 yellow RAL 1003			
300 mm	1	358 / 371 / 130 [445*]	3,5			colour combinations are possible (back/front)			
	2	358 / 743 / 130 [445*]	6,9						
	3	358 / 1113 / 130 [445*]	10,3						

* depth with visors

** the stated values are estimates



Figure 2: Domeni i temperaturës punuese i shkëputur nga katalogu i prodhuesit ZIR për tipin e semaforit ZIRSlim, ku shihet se plotëson kërkesën minimale të kërkuar në dosje të tenderit. Krahasimi me ofertën e Traffiks VA – emri skedes 15 Traffiks VA...Katalogjet, fajlli 2. ZIRSlim_eng, faqe 2

Në dosje të tenderit është kërkuar që semafori duhet të jetë i përshtatshëm për funksionim në ambiente të jashtme në interval temperaturash jo më të ngushtë se -40°C deri +65°C dhe të jetë

në përputhje me kërkesat përkatëse të EN 12368.

Ndërsa ankesa juaj për shkallën e mbrojtjes IP65 është e arsyeshme dhe e argumentuar.


Pretendimi 2 është pjesërisht i bazuar.

-Pretendimi 3: Në lidhje me këtë pretendim, kemi vizituar web faqen zyrtare të prodhuesit EKALDES (ekaldes.com) ne te cilen kemi gjetur katalogun e titulluar “2026 sinyalizasyon katalogu”, katalog te cilin e keni bashkangjitur edhe në ofertën tuaj. Kjo për të mësuar më tepër për produktet që kompani prodhon dhe për ti krahasuar tutje me kërkesën e dosjes së tenderit.



Pas ri-analizimit të ofertës tuaj në këtë pikë dhe krahasimit me kërkesën e dosjes së tenderit për Shtyllat nga materiali fleksibil me ndriçim LED dhe Dritave tërthore LED, kemi konstatuar se produktet me të cilat keni ofertuar nuk plotësojnë kërkesën e formës dhe dizajnit si dhe nuk plotësojnë karakteristikat minimale teknike, po ashtu dhe nuk kanë deklarata të EU konformitetit siç është kërkuar në dosje të tenderit.

Krahasimi i formës dhe dizajnit:

Shtyllat nga materiali fleksibil me ndriçim LED



KËRKESA NË DOSJE TË TENDERIT	OFERTA JUAJ
	2.9. Pedestrian crossing bollard.  <i>Shkeputur nga fajlli - 6 Furnizuesit e Matrijalit1-180 Kerkesa 1, faqe 149, shtyllë me drita led gjatësore në trupin e saj, pa "kokë" me led, pa shirita reflektues.</i>


Dritave tërthore LED

KËRKESA NË DOSJE TË TENDERIT	OFERTA JUAJ
 Drita tërthore LED e kërkuar, me gjatësi të një trajtshme pa shkëputje në 3, 4, apo 5 copa siç e ofron EKALDES	 Shkëputur nga fajlli - 6 Furnizuesit e Matrijalit1-180 Kërkesa 1, faqe 139

Nga ky krahasim vërehet qartë mos përputhja e ofertës tuaj me formën dhe dizajnin e kërkuar në dosje të tenderit.


Krahasimi i specifikimit teknik, përjashtimisht pikat në të cilat është plotësuar kërkesa minimale po ju ri-sqarojmë pikat e mos përputhjes me dosjen e tenderit.

2.1	KËRKESA për Shtyllat fleksibile me LED drita në maje për vendkalim të këmbësorëve	Produkti i EKALDES
4	Folia reflektive E vendosur në maje të shtyllës me dy shirita me folie 3M apo e ngjashme (ngjyra: e bardhë ose e verdhë)	Nuk ka shirita me folie, nuk është paraqitur as në katalog – Nuk plotëson kërkesën 2.5. Reflektor ushtrorë hollid.  
5	Rezistenca në goditje Trup elastik me memorie i cili pas goditjes kthehet në gjendje paraprake	Nuk është elastik, nuk është paraqitur as në katalog – Nuk plotëson kërkesën, trupi jo elastik, materiali i trupit Alumin

			Profile section  Construction aluminum / PU
6	Përbërja e shtyllës	Unazë me drita LED e vendosur në maje e dukshëm 360 shkallë	Dritat LED të vendosura përgjatë shtyllës e jo në maje të dukshëm 360 shkallë – LED dritat te vendosura me shirit gjatësor jo në unazë në maje - Nuk plotëson kërkesën
7	LED dritat	Numri: 12, tipi: High Power LED	Nuk është treguar numri i dritave LED – Nuk plotëson kërkesën
10	Certifikimi – Deklarimi i Konfirmimit, të dorëzohet me ofertë	1. Në përputhje me standardin: IEC 60598-2-13:2006 + A1:2011+A2:2016, IEC 60598-1: 2020, EN 60598-2-13: 2006 + A1: 2012 + A2: 2016 + A11: 2021 and EN IEC 60598-1: 2021 + A11: 2022. 2. Në përputhje me standardin: EC 62493: 2015 and EN 62493: 2015 3. LED moduli i testuar në bazë të standardit IEC 62031: 2018, EN IEC	Të ofruara EN 12368:2006, EN 40-5:2002, EN 40-6:2002, ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018 – As njëra nga certifikatat nuk është kërkuar, nuk ka deklaram të konformitetit sipas standardeve të kërkuara – Edhe pse keni bërë ankesë prapë nuk keni dëshmuar se produkti ka Certifikim – Deklarim të Konfirmimit, Nuk plotësohet kërkesa

		62031: 2020 + A11: 2021	
--	--	------------------------------------	--

Krahasimi i specifikimit teknik, përjashtimisht pikat në të cilat është plotësuar kërkesa minimale po ju ri-sqarojmë pikat e mos përputhjes me dosjen e tenderit

2.2	Kërkesa për Dritat tërthore LED për vendkalim të këmbësorëve	Produkti i EKALDES
3	Dimensionet për copë	1000 x 100 x 48 mm Dimensionet e ofruara: 1480mm, 1480mm dhe 2200mm, gjerësia 1065 mm-- Nuk plotësojnë kërkesën Technical detail 
5	LED konfigurimi	Matrix 110° Nuk tregohet të paktën këndi i dukjes - Nuk plotësojnë kërkesën
6	Tipi i LED-it	RGB PLCC6 3535 Nuk tregohet - Nuk plotësojnë kërkesën
7	Shkalla e mbrojtjes	IP67, IK10 Nuk tregohet - Nuk plotësojnë kërkesën
9	Materiali i mbështjellësit dhe bazës	Çelik inox, polikarbonat, baza nga alumini Ka bazë të aluminit mirëpo jo pjesa e sipërme prej çelikut inox - Nuk plotësojnë kërkesën
12	Certifikimi – Deklarimi i Konfirmimit, të dorëzohet me ofertë	1. Në përputhje me standardin: IEC 60598-2-13:2006 + A1:2011+A2:2016, IEC 60598-1: 2020, EN 60598-2-13: 2006 + A1: 2012 + A2: 2016 + A11: 2021 and EN IEC 60598-1: 2021 + A11: 2022. 2. Në përputhje me standardin: EC 62493: 2015 and EN 62493: 2015 Të ofruara EN 12368:2006, EN 40-5:2002, EN 40-6:2002, ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018 – As njëra nga certifikatat nuk është kërkuar, nuk ka deklarim të konformitetit sipas standardeve të kërkuara – Edhe pse keni bërë ankesë prapë nuk keni dëshmuar se produkti ka Certifikim – Deklarim të Konfirmimit, Nuk plotësohet kërkesa

		3. LED moduli i testuar në bazë të standardit IEC 62031: 2018, EN IEC 62031: 2020 + A11: 2021	
--	--	--	--

Në kërkesën e dosjes së tenderit nuk është kërkuar modifikim i shtyllave dhe LED dritave tërthore nga prodhuesi, por është kërkuar formë dhe dizajn fiks, i modeluar dhe prodhuar paraprakisht nga prodhuesi, i vendosur dhe i jetësuar në rrugët e qyteteve të ndryshme, përfshirë edhe qytetin e Gjakovës ku janë të vendosura që nga viti 2023 drita tërthore LED me dizajn dhe formë të njëjtë.

Me gjithë respektin për prodhuesin EKALDES dhe juve si kompani, ju sqarojmë tutje se njësia e kërkesë pranë Komunës së Gjakovës nuk është e interesuar të blej dhe të vendos produkte që modifikohen/përshtaten e që nuk janë prodhuar dhe vendosur më parë sipas materialit, formës dhe dizajnit të kërkuar në dosje të këtij tenderi.

Pretendimi 3 është i pa bazuar.

-Pretendimi 4: Pajisa në listë me nr 8 në listë kishte kërkesën: *''Makinë për realizimin e sinjalizimit horizontal me ngjyrë termo-plastike me kapacitet minimum 400 litra''*. Ju keni ofruar 1 makinë e cila sipas deklaratës doganore është e markës Hoffinan – VSV e viti 1992.

Nga ri-analizimi i dëshmimeve të bashkangjitura, përkatësisht: Fatura me nr: M23549, Nr.DUD: R 34699 20.08.2022 + Foto, rezulton se nuk keni ofruar dëshmi në lidhje me kapacitetin minimum 400 litra siç është kërkuar në dosje të tenderit.

Edhe pse jeni ankuar në këtë pikë dhe pretendoni se makina juaj ka kapacitetin më të madh se 400 litra, nuk keni sjellë dëshmi shtesë që tregon kapacitetin e saj.

Pretendimi 4 është i pa bazuar.

Ankimimi në ofertën e operatorit të rekomanduar për kontratë TRAFFIKS VA SH.P.K.

-Pretendimi 1: Në qasje doc. "10 Traffiks Va..Deklaratat e konfirmimitit.rar" identifikohet ZIRSlim-Certifikatat.pdf për semaforët, por nuk ka certifikatë Të kontrollit EN 50556 ose EN 12675. Katalogu ZIR..

Ju sqarojmë se ZIRSlim është semafor (latem) e jo kontrollor, ndërsa kontrolleri që është ofruar është ITC3-PL Controller (shiko fajlli: 1. Kontrolleri Technical Data-ITC3-PL_EN.pdf, faqe 2), në të dhënat teknike e të cilit tregohet se ky kontrollor është i testuar dhe certifikuar sipas certifikimit:

1.PN-EN 12675:2000 Signalling controllers -- Functional safety requirements

2.PN-EN 50293:2012 Road traffic signal systems -- Electromagnetic compatibility

3.PN-EN 50556:2011 Road traffic signaling systems


4.PN-EN 60950-1:2006 Information technology equipment -- Safety-- Part 1: Basic requirements

5.PN-EN 61508 SIL3 Functional safety of control systems

CERTIFICATION

The ITC3-PL controller has been tested and certified (by appropriate certifying bodies) according to Polish and European safety standards:

- or PN-EN 12675:2000 Signalling controllers -- Functional safety requirements
- or PN-EN 50293:2012 Road traffic signal systems -- Electromagnetic compatibility
- or PN-EN 50556:2011 Road traffic signaling systems
- or PN-EN 60950-1:2006 Information technology equipment -- Safety -- Part 1: Basic requirements
- or PN-EN 61508 SIL3 Functional safety of control systems



ul. Przemysłowa 5, 41-902 Bytom
+48 32 387 85 26
info.ssr@zir.com.pl
www.grupazir.pl

Nga ri-shqyrtimi i dokumenteve të ofruara nuk kemi gjetur certifikatat EN 50556 – Road Traffic Signal system dhe EN 12675 – Traffic signal controllers – Functional safety requirements si dokumente të veçanta, të cilat janë kërkuar që të dorëzohen me ofertë.

Pretendimi 1 është i bazuar.

-Pretendimi 2: Dokumentacioni teknik ZIR i qasshëm përmend përputhje/certifikim me PN-EN 61508 SIL3 në materialin e produktit, por në paketën e deklaratave/certifikatave të qasshme nuk identifikua një certifikatë SIL3 të kontrollit.

Edhe pse në pikën më lartë u dëshmuar se në bazë të të dhënave teknike të kontrollit të ofruar, ky kontroll është i testuar dhe certifikuar me PN-EN 61508 SIL3 Functional safety of control systems. Pra plotëson kërkesën për siguri SIL3, konsiderojmë se duhet të kërkohej sqarime, përkatësisht të dëshohet certifikata përkatëse.

Pretendimi 2 është pjesërisht i bazuar.

-Pretendimi 3: Katalogu ZIR i qasshëm dokumenton touchscreen, adaptive local control SMART INTERSECTION, SMART CORRIDOR, ZIR-PRIORITY, mbikëqyrje të sigurisë dhe disa standarde. Megjithatë, në dokumentet e marrura në qasje nuk identifikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha vlerat/funksionet e mësipërme, veçanërisht 40 detektorë, 128 I/O, 2W, C-ITS/V2X dhe kategoritë e plota të prioritetit.

Nga ri-analizimi i katalogut dhe të dhënave teknike për kontrollin e ofruar ITC3-PL Controller të prodhuesit ZIR, ju sqarojmë se kërkesa në FDT për dedektorët ishte të ketë mundësi integrimit deri në 40 dedektorë, në të dhënat teknike tregohet se ky kontroll ka mundësi të jetë me panel ITC3-PL/24: 19" rack cassette, up to 24 signal groups, që është i

mjaftueshëm për integrim të 40 dedektorëve. Tutje tregohet se ky kontrollor mund të ketë deri në 192 hyrje/dalje të sinjaleve.

Dhe vetë fakti që është kontrollor i tipit ITC-3 (Intelligent Traffic Controller Serie 3) tregon se është një ndër kontrollorët më të avancuar në treg ku mund të integrohen pajisje që mundësojnë komunikim me infrastrukturë V2X dhe është kontrollor që integron C-ITS (Cooperative Intelligent Transport Systems).

Këto të dhëna janë të paraqitura në të dy fajllat 1. Kontrollori Technical Data-ITC3-PL_EN dhe 1.1 Kontrollori ITC-3 ZIR.

Kontrollori i prodhuesit ZIR tipi ITC3-PL Controller, plotëson kriteret minimale teknike.

Pretendimi 3 është i pa bazuar.

-Pretendimi 4: Në “15 Traffiks Va..Katalogjet.rar” gjenden paralelisht katalogë për “1. Kontrollori Technical Data-ITC3-PL_EN.pdf”, “1.1 Kontrollori ITC-3 ZIR.pdf” dhe “ITC-3 Traffic Controller Datasheet.pdf” të SWARCO. Autorizimi është prezantuar nga Elektromodul-Promet dhe lidhet me ZIR si prodhuesi i pajisjeve semaforike. Nuk ka asnjë kuptim që ZIR të prezantohet si prodhues i pajisjeve dhe të prezantohet një Katalog i një kompanie tjetër për të cilën nuk ka autorizim.

Sic u cek më lartë, ju sqarojmë se është analizuar dhe krahasur me kërkesën e DT-ës kontrollori i prodhuesit ZIR, për të cilin siç e keni potencuar ofertuesi Traffiks VA ka prezantuar autorizimin nga dileri i autoizuar i prodhimeve të ZIR.

Pretendimi 4 është i pa bazuar.

Pretendimi 5: “ZIRSlim-Certifikatat.pdf” ne qsjë përmban faqet e shënuara 1 (23) dhe 2 (23). Në faqen 2, për luminous intensity dhe maximum phantom signal shkruhet “See Table(s) 1 and Table(s) 2 for details”. Tabelat referuese nuk janë pjesë e dokumentit 2-faqësh.

Certifikata e dorëzuar e prodhuesit ZIR për tipin e semaforëve ZIRSlim është certifikatë e cila tregon qartë se ky produkt prodhohet sipas standardit EN 12368:2006 dhe të dhënave tjera të kërkuar në dosje të tenderit për pjesën e semaforëve.

Pretendimi 5 është i pa bazuar.

-Pretendimi 6: Certifikata ZIRSlim identifikon signal heads me nominal size 200 mm dhe 300 mm. Nuk identifikuam certifikim nominal 210 mm në dokumentet e qasjes, kërkesa për 210mm është jashtë standardit.

Ju sqarojmë se në dosje të këtij tenderi janë kërkuar semafor me diameter 300mm, 210mm ose 200mm, pra semaforet për automjete dhe këmbësorë kanë diameter 200 mm ose 210 mm, kjo varet nga prodhuesi disa prodhues prodhojnë semafor me 200 mm disa me 210 mm, në mënyrë që të mos ngushtohet konkurrenca në ofertim është konsideruar që mund të ofertohej me 200 mm ose 210mm, pra të dy diametrat për semaforet kanë qenë të pranueshme.

Ju përmes prodhuesit SCAE keni ofertuar me semafor me diameter 300mm dhe 210 mm, dhe në këtë aspekt kanë qenë të pranueshëm.

Prodhuesi ZIR prodhon semafor me diamter 300 mm dhe 200 mm, andaj e plotëson kërkesën minimale të tenderit.

Pretendimi 6 është i pa bazuar.

-Pretendimi 7: Certifikata ZIRSlim gjatë qasjes e klasifikon produktin në Temperature Classes A/B/C që është normale sipas standardit.

Domeni i temperaturës punuese i prodhuesit ZIR për tipin e semaforit ZIRSlim, e plotëson kërkesën minimale të kërkuar në dosje të tenderit. Më poshtë krahasimi me ofertën e Traffiks VA – emri skedës 15 Traffiks VA...Katalogjet, fajlli 2. ZIRslim_eng, faqe 2

LEDs lameter	Number of aspects	Dimensions width / height / depth (mm)	Weight (kg)	Material	Assembly	Available colours	Temperature class	Resistance	UL Certificat
100 mm	1	269 / 264 / 130 (345°)	1.3	UV stabilized polycarbonate	Double support by means of polycarbonate (160 mm) or aluminium (200 mm) bracket, horizontal or vertical assembly.	black RAL 9005	A, B and C (-40°C to +65°C) in compliance with PN-EN 12368:2006	IR3 in compliance with PN-EN 12368:2006	Full conformity with PN-EN 12368:2006
	2	269 / 527 / 130 (345°)	3.6			grey RAL 7032			
	3	269 / 791 / 130 (345°)	5.4			green RAL 6009			
100 mm	1	358 / 371 / 130 (445°)	3.5		Assembly of screens with use of self-tapping screws.	yellow RAL 1003			
	2	358 / 743 / 130 (445°)	6.9			colour combinations are possible (back/ front)			

Pretendimi 7 është i pa bazuar.

-Pretendimi 8: Në dokumentet e qasjes “9 Traffiks Va..Deklaratat e konfirmitetit.rar” identifikohen “Technical File - SR-CITY-BALI-TL-R - Rev.0.pdf”, “EU Declaration of Conformity - SR-CROSSLED-15/20L.pdf” dhe “EU Declaration of Conformity - PC-500 EMC.pdf”. Nuk identifikohet skedar EU Declaration of Conformity për SR-CITY-BALI-TL-R.

Nga ri-shqyrtimi i dokumenteve të ofruara nuk kemi gjetur EU deklarinimin e konformitetit për Shtyllat fleksibile me LED drita në majë për vendkalim të këmbësorëve si dokumente të veçanta, të cilat janë kërkuar që të dorëzohen me ofertë.

Pretendimi 8 është i bazuar

-Pretendimi 9: Oferta përmban katalogë për dy modele të ndryshme: SR-CITY-BALI-TL-R dhe SR-CITY-BALI-TSL-R. Në dokumentacionin TL-R të qasshëm nuk kemi identifikuar qartë provën IP68/IK10. Karakteristikat e modelit tjetër TSL-R nuk mund të përdoren automatikisht për modelin TL-R, sepse është produkt tjetër dhe konfigurimi LED ndryshon.

Ju sqarojmë se nga analizimi i shtyllave të ofruara të prodhuesit SERNIS të tipit SR-CITY-BALI, këto shtylla plotësojnë kriteret teknike minimale dhe plotësojnë dizjantin dhe formën e kërkuar në FDT. Po ashtu kanë shkallën e mbrojtjes IP68 dhe IK10.

Pretendimi 9 është i pa bazuar

-Pretendimi 10: Katalogu SR-CROSSLED-L i dorëzuar shkruan në faqen 1 “LEDs Configuration: Linear 110°” dhe në faqen 2 “LED’s Configuration: Linear with 110° viewing angle”.

Ju sqarojmë se SR-CROSSLED-L të prodhuesit SERNIS kanë këndin e dukjes 110° të formës lineare që është më i mirë në aspektin teknik se sa matrix 110°, pra në këtë aspekt ky produkt është më i mirë se sa kërkesa në dosje të tenderit, pra është mbi kërkesën minimale.

Pretendimi 10 është i pa bazuar.

-Pretendimi 11: Katalogu SR-CROSSLED-L deklaron "Operation Mode: Steady Light". Në faqen teknike thuhet se other modes of operation and dimming janë available with external controller, por nuk identifikohet shprehimisht pulsing mode si karakteristikë e produktit të ofertuar.

Ju sqarojmë se dritat SR-CROSSLED-L janë drita të cilat vendosen në hyrje të vend-kalimit për këmbësorë dhe si të tilla lidhen me semaforin e këmbësorëve dhe japin driten e njejtë sikur në semaforin për këmbësorë, pra kanë mundësi të pulsimit dhe të dritës së njëtratshme. Këtë përshkrim e keni edhe në katalogun e prezantuar nga ofertuesi (Amber color, other modes of operation and dimming are available with external controller). Pra kur lidhet me sinjalin e semaforit pulson varishtë nga sinjali që ja përqon kontrolleri i semaforëve.

Pretendimi 11 është i pa bazuar,

-Pretendimi 12: Autorizimi është lëshuar nga Elektromodul-Promet d.o.o., i cili deklaron se është regional representative i ZIR dhe autorizon TRAFFIKS VA. Në paketën e dokumenteve ne qasje nuk kemi identifikuar një dokument të veçantë ZIR → Elektromodul që demonstroi statusin e dilerit/përfaqësuesit për territorin dhe produktet e ofertuar.

Nga ri-shqyrtimi i dokumenteve të ofruara nuk kemi gjetur dokument që tregon se Elektromodul është diler i autorizuar i prodhuesit ZIR, edhe pse është kërkuar autorizimi i dilerit apo prodhuesit, konsiderojmë se ky dokument duhet të kërkohet me qëllim të verifikimit.

Pretendimi 12 është i bazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:

Operatorit Ekonomik;

Zyrës së Kryetarit të Komunës;

Të gjitha palëve të interesuara;

FATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.